

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Data \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje materiale ndërtimi” .

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 44110000-4; 44110000-1

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1,867,948 (një milion e tetqënd e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4, me vlerë 37,358.96 (tridhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë nentëdhjet e gjashtë) Lekë.*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, te ndryshuar nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.*

**Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një

nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në të cilin parashikohet se: “Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomike nuk mund të tejkalohet: (c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

Kërkesa e mesiperme është në përpjestim dhe e lidhur ngushte me objektin e kontrates. Ajo i shërben UKRK sh.a për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomike dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontrates. Vlera e xhiros që kërkohe është në përputhje me vlerën e përcaktuar në nenin 43 pika 2.c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4, b ku përcaktohet shprehimisht, citojmë: “ Për kontratat e mallrave vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ”

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht: a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të

operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është hartuar në mbështetje të nenit 79, pika 1, ku citohet si vijon: "1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë..."*

*Gjithashtu bazuar edhe në neni 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) konkretisht: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit..."*

*Për vetë natyrën dhe rëndësinë e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që, operatorët si zbatues të kontratës, të kryejnë veprimtarinë në përputhje me standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve, reputacionit dhe besueshmërisë së operatorëve ekonomikë. Konkretisht: **ISO 9001:2015** (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

*Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht -1 person**, për muajin **Shkurt 2026**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të vërtetojë disponimin e numrit minimal të punonjësve nëpërmjet dokumentave si më poshtë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve .
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur në raport me sasinë e mallrave që do të furnizohen.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallit të kërkuar në objekt prokurimi, pranë Autoritetit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që do të kryejne me efikasitet zbatimin e procedures , sipas kerkesave te AK.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**\* Specifikimet teknike bashkëlidhur janë hartuar nga Njësia e Prokurimit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**